

INFORMACION PER NXENESIT E HUAJ

Nga (Albanese)

A. Informacione specifike mbi shkollen

Emertimi.....

Lloji i shkolles.....

Adresa.....

Nr. i telefonit.....

Nr. i faksit.....

E. mail.....

B. Informacione specifike mbi personelin dhe mbi funksionimin e shkolles

Drejtori i shkolles:.....

Drejtori i Sherbimeve te Pergjithshme e Administrative:.....

Mesuesi me funksion mekembsi:.....

Mesuesi referent per nxenesit e huaj:.....

Orari i i sportelit te Sekretarise:.....

Orari i hyrjes ne shkolle te nxenesve:.....

Orari i daljes se nxenesve nga shkolla:.....

C. Regjistrimi ne shkolle

Nxenesi regjistrohet ne klasen qe i korrespondon moshes se tij te vertetuar apo te deklaruar. Megjithate shkolla mund te vendose ta rregjistroje nxenesin ne nje klase me te ulet se moshja perkatese, pasi te kete marre ne shqyrtim studimet e ndjekura ne vendin e lindjes dhe te kete verifikuar njohurite, aftesite dhe kompetencat qe ka nxenesi ne momentin e regjistrimit.

⇒ **Cfare duhet bere per t'u regjistruar ne shkolle**

1. Te paraqiteni ne shkolle per te terhequr modularin e regjistrimit
2. Te mbushni modularin duke ndjekur syzjerimet e shkruara ne modular
3. Te dorezoni modularin ne Sekretari.

⇒ **Dokumente qe duhet t'i bashkangjiten modularit te regjistrimit:**

1. Dokumenta te gjendjes civile

- Karta e identitetit
- Kodi fiskal
- Çertificata e lindjes
- Akti i shtetesise

Ne mungese te njerit apo te disa dokumentave te siperpermendura: vetevertetim (autocertificazione) te te dhenave te kerkuara.

2. Dokumenta shendetesore

- Libreza e vaksinimit

Ne mungese te ketij dokumenti nxenesi mund te filloje shkollen. Familja mund t'i drejtohet Ndermarrjes Shendetesore Lokale (Azienda Sanitaria Locale) ASL per te kontrolluar dokumentacionin ose, ne rast se nevojitet, per te bere vaksinat qe femija nuk i ka bere.

3. Dokumenta shkollore

Per t'u regjistruar ne shkolle nevojitet nje dokument qe verteton studimet qe nxenesi

ka ndjekur ne vendin e lindjes. Dokumenti duhet te shoqerohet nga perkthimi zyrtar ne gjuhet italiane.

D. Informacione te dobishme

Sekretaria mund t'ju ofroje informacione te dobishme mbi argumente qe ju interesojne. Ne vecanti mund t'ju jape informacione lidhur me:

- Taksat shkollore
- Kontributet e laboratorit
- Transportimit me mjete publike
- Sherbimit te mences
- Librave shkollor
- Bursave te studimit
- Sigurimeve (Assicurazioni)

E. Informacione baze mbi kalendarin shkollor dhe mbi organizimin.

Ne Itali aktivitetet didaktike zgjasin te pakten 200 dite. Si rregull, shkolla fillon ne pesembedhjetediteshin e dyte te shtatorit dhe mbaron brenda 10 qershorit.

Pushimet e vendosura nga ligji jane:

- 13 dite ne periudhen e krishtlindjeve dhe vitit te ri
- 6 dite per pashket

Pushimeve gjate festave te mesiperme i shtohen edhe ato ne ditet e festave kombetare e rajonale, civile e fetare te shenuara ne kalendar.

Nxenesi eshte i detyruar te ndjeke te gjitha oret e mesimit.

Paradite mesimi fillon cdo dite ne oren..... dhe mbaron ne oren

Mbasdite mesimi fillon ne orendhe mbaron ne oren..... ne ditet

Gjate mengjesit si rregull behet nje pushim qe zgjat Gjate ketij pushimi nxenesi eshte i detyruar te qendroje brenda shkolles.

Cdo klase eshte e perbere nga djem dhe vajza te cilet jane te barabarte pa diferenca qe kane te bejne me te qenit e tyre meshkuj apo femra.

Familja mund te zgjedhe nese femija te ndjeke ose jo oren e Fese Katolike. Kjo zgjedhje behet me ane te nje modulari qe gjendet prane sekretarise.

F. Mungesat dhe vonesat

Prinderit duhet te justifikojne e t'i bejne kerkese shkolles ne rast se nxenesi qe s'ka mbushur moshen 18 vjec ben mungesa, vjen me vonese apo del para mbarimit te ores/ve te mesimit. Nese nxenesi ka mbushur moshen 18 vjec mund te justifikoje e te beje kerkesen personalisht.

Informacione te metejshme mbi rregullat dhe menytrat e sjelljes gjenden ne Rregulloren e Shkolles. Mund te terhiqni nje kopje prane sekretarise.

G. Cfare behet ne shkolle

Dokumentit qe permbledh gjithcka behet ne shkolle eshte Plani i Ofertes Formative (ose sic njihet ndryshe me emrin P.O.F.)

Nje permbledhje e P.O.F.-it i dorezohet familjes ne momentin e rregjistrimit. Ai permbledh:

- Qellimet edukative
- Orarin javor te mesimeve
- Lendet e mesimit
- Projekte qe i shtohen programit shkollor si, projekte qe synojne mirepritjen dhe futjen e nxenesve te huaj ne shkolle, kurse qe mbeshtesin mesimin e gjuhes italiane nxenesve te huaj.
- Aktivitete qe kane per qellim tutelimin e gjuhes dhe traditave te nxenesve te huaj dhe njohjen mes nxenesve me ane te shkembimit interkulturor.

Teksti i plote i POF.it gjendet prane Sekretarise ne Tabelen e njoftimeve te shkolles.

Drejtori i shkolles

TAKIMET ME MESUESIT E SHKOLLES

(Informacione mbi takimin me mesuesit qe do te behet menjehere pas regjistrimit)

QELLIMET

- Te mirepresin e te shoqerojne nxenesit gjate vitit shkollor me qellim qe te reduktojne mossuksesin, izolimin nga femijet e tjere dhe ta ndihmojne te vazhdoje studimet edhe pse do te kete veshtiresi ne fillim.
- Te promovojne integrimin e femijeve duke respektuar diferencat etnike e kulturore;
- Te mbledhin informacione mbi historine personale, familjare e shkollore te nxenesit;
- Te informohen se cilat jane aspiratat e femijes e te familjes ne lidhje me shkollimin e tij.
- Te jape informacione mbi organizimin e sherbimit shkollor
- Te jape informacione mbi marredheniet mes shkolles e familjes.

MENYRAT E ZHVILLIMIT TE TAKIMIT

- Biseda me mesuesit zhvillohet ne disa faza brenda mjedisit shkollor, me qellim qe ambjenti te jete i pershtatshem e qe te dyja palet te njihen ne nje klime besimi e respekti.
- Informacione qe jep familja nuk behen publike nga ana e shkolles.
- Ne qofte se ben kerkese familja mund te marre nje kopje te bisedes qe ben me mesuesit.

PERFAQESUES TE SHKOLLES QE MARRIN PJESE NE TAKIM

Pervec drejtorit te shkolles ose nje zevendesues te tij ne takim marrin pjese personat e meposhtem:

- Pergjegjesi ose referenti per emigracionin te zgjedhur nga shkolla
- Ndermjeteresi gjuhesor/kulturor (mediatore linguistico/culturale)
- Mesuesi i gjuhes amtare te studentit (nese ekziston ne shkolle)
- Mesuesi i gjuhes italiane te klases se nxenesit
- Kordinatori i klases se nxenesit

PERMBAJTJA E BISEDES

TE DHENA PERONALE TE NXENESIT

- Emri, mbiemri, gjinia, shtetesia, data e lindjes, data kur ka arritur ne Itali, gjuha amtare (L1), vendbanimi (residenza), mjetet e transportit qe perdor per te shkuar ne shkolle, nevoja te lidhura me ushqimin (nese ha ne mence), rrethana te vecanta.

INFORMACIONE MBI FAMILJEN

- Perberja e familjes
- Historia e emigracionit te familjes
- Punesimi i pjestareve ne Itali
- Jeta e familjes ne atdhe (punesimi i pjestareve; pershkrimi i baneses, e komshnjve, e vendeve qe kane frekuentuar, lloji i ushqimit qe perdorin me shume, ngjarje publike, kenge, transmetimet televizive me te ndjekura, traditat popullore qe i interesojne ne menyre te vecante, marredheniet me autoritetet ne atdhe; aktivitetet sportive me te perhapura, me cfare intervalesh lexojne libra, perdorin telefonin, kompjuterin, internetin)

CFARE SHKOLLE KA NDJEKUR

- Informacione mbi arsimimin qe ka ndjekur femija, lendet qe i pelqejne me shume, veshtiresite qe ka hasur, marredheniet me mesuesit e me shoket e klases.

NIVELI GJUHESOR

- Informacione mbi gjuhen e folur nga nxenesi (L1)
- Njohja e gjuheve te tjera (L2, L3)
- Njohurite gjuhesore te familjes (gjuha/et e folur/a nga familjaret)
- Niveli i njohjes se gjuhes italiane nga familjaret (per te percaktuar nivelin eshte e keshillueshme te perdoren nivelet "Baze", "Te pavarur", "Zoterimi" sic sygjeron Kuadri i Pergjithshem Evropian i perpiluar nga Keshilli i Evropes¹).
- Niveli i njohjes se italiashtes nga nxenesi
- Prania ne familje, ose jashte saj, e nje ndermjeteresi gjuhesor/kulturor.

AKTIVITETET JASHTESHKOLLORE APO PRIRJET PERSONALE

- Aktivitetet sportive
- Frekuentimi i moshatareve (italiane/te huaj, meshkuj ose femra) jashte orarit te mesimeve.
- Si e kalon kohen e lire
 1. Koha qe kalon cdo dite para televizorit
 2. Koha qe kalon cdo dite duke lexuar
 3. Koha qe kalon cdo dite duke luajtur ne shtepi
 4. Koha qe kalon cdo dite duke luajtur jashte shtepise

¹ Kuadri Evropian te cilit i referohemi ha vendosur parametrat e pergjithshme per njohjen e gjuhes komunitare, duke i ndare ne tre nivele: baze, te pavarur dhe zoterimin. Secili nga keta livelle permban dy nen nivele:

- ⇒ A1 niveli fillestar ose i zbulimit dhe A2 niveli i mesem ose i mbijeteses;
- ⇒ B1 niveli i pare qe mbyll fazen fillestare dhe B2 niveli i pavarur;
- ⇒ C1 niveli i eficasiteit me bavaresi te plote dhe C2 niveli i avancuar, zoterimi i gjuhes ne rrethana te vedhtira.

da "Gli alunni con cittadinanza non italiana a Livorno e provincia", N.A.Langella – L. Lessi, U.S.P. di Livorno, 2008.